



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 252

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E Z. LAZJON VANGJEL PETRI SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT BASHKIAK, BASHKIA KORÇË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 3.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Komiteti Nismëtar për regjistrimin e z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, si anëtar në këshill bashkiak

OBJEKTI: Regjistrimi i z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, si anëtar në këshill bashkiak

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 70 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 148, datë 08.3.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar Komitetin Nismëtar i cili do të organizojë punën për paraqitjen e z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Data: 3.4.2023 Nr: 252
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Lazjon Vangjel Petri si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Me shkresën datë 23.2023, komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet mbështetëse të 1300 (njëmijë e treqind) zgjedhësve.

Bashkëlidhur është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë vijon:

- Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie të posaçme, Model KQZ-04-08,
- Jetëshkrim i kandidatit, Model KQZ-04-10,
- Listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështesin kandidatin të nënshkruar prej tyre sipas Model KQZ-04-01, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit,
- Formulari i vetëdeklarimit,
- Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit, Model KQZ-00-31.

Neni 70, pika 3 përcakton se, Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Komiteti Nismëtar ka depozituar 1300 (një mijë e treqind) firma mbështetëse sipas përcaktimeve ligjore.

Administrata e KQZ-së verifikoi nënshkrimet e zgjedhësve në listat mbështetëse për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak Bashkia Korçë, për të cilat rezultoi se janë regjistruar 1300 (një mijë e treqind) nënshkrime të plotësuar sipas modelit. Për çdo zgjedhës në listë është depozituar dhe kopje e letërnjoftimit e nënshkruar prej tyre.

Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstratin e përbërësve zgjedhorë rezulton se janë zgjedhës të zonës zgjedhore Bashkia Korçë. Numri i zgjedhësve të verifikuar është 53 (pesëdhjetë e tre).

Pas verifikimeve përkatëse të dokumentacionit në tërësi për regjistrimin e z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për anëtar në këshillin bashkiak Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 70 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kandidati për anëtar në këshillin bashkiak Bashkia Korçë z. Lazjon Vangjel Petri, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 672, datë 18. 03.2023, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin, e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me anë të komunikimit elektronik në datën 29.3.2023, ka

dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak, Bashkia Korçë, i cili rezulton i padënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në Këshillin Bashkiak Korçë.

Në bazë të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatin për anëtarë në këshillin bashkiak, Bashkia Korçë, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 70 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

V E N D O S:

1. Regjistrimin e z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për anëtar në këshillin bashkiak Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI